



REPUBLIKA KOSOVËS  
DOKUMENTI NGA KUVENDIT KOMUNAL I KUVENDIT PUBLIK

Dokumenti i kuvendit komunal i Kuvendit publik

UPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE

Daljnjelozna 119

Nr. 19.09.2022

Priredil: Obilić



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Kuvendi Komunal Obilić - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

## E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.28.07.2022, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin këta anëtarë:** Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Labinot Mirena (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala (IQO), Florije Jashari (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Ajshe Haliti Pllana (LVV), Valon Svirca (LVV), Albanë Shillova Shalaku (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Bajram Hashani (LDK), Linda Sadiku Krasniqi (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristic (SL) dhe Biljana Spasic (SL).

**Të pranishmit tjera:** Ibush Mjekiqi, Nënkyetar i Komunës, Slavisa Jakovljevic, Nënkyetar për komunitete, drejtës komunal, Burim Gërguri, shef i kabinetit të Kryetarit, Festina Preniqi, zyrtare për marëdhënie me publikun, përf. i IZHL-së, dhe përf.e OSBE-së

Mbledhjen e udhëhoqi Enver Gashi, anëtarë më i vjetër i Kuvendit, i cili, pasi konstatoi se ka kuorum filloj mbledhjen me këtë:

### R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Draft Rregullores për menaxhimin e mbeturinane në Komunën e Obiliqit
4. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve për periudhën Janar – Qershor 2022
5. Raporti i Auditimit nga ZKA për vitin 2021
6. Plani i Veprimit për zbatimin e Rekomandimeve nga ZKA
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së DPUKP-së, për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr. - I-69, të dt.30.04.2021
8. Shqyrtimi i kërkesave
9. Të ndryshme

**Enver Gashi** – Ju njoftoj se kryesuesja mungon për arsyen se ka rast vdekje dhe sipas Rregullores, më takon mua me udhëheqë këtë mbledhje. Është një ndryshim në rendin e ditës me kërkesën e Kryetarit të Komunës dhe propozoj që në pikën 8 të rendit të ditës të hyjë raporti i Komisionit për pronat e dhëna në shfrytëzim. Miratohet rendi i ditës unanimisht me ndryshimin e cekur më lartë.

**Pika 1 e rendit të ditës**

**Mungoi:** Vlora Mjekiqi Kabashi me arsyen

**Pika 2 e rendit të ditës**

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 13 vota për dhe me 4 vota kundër.

**Pika 3 e rendit të ditës**

**Labinot Mrena** - Unë kërkoj që pikën e tretë të rendit të ditës me shtye për muajin e ardhshëm për shkak se është një çmimore më shumë se 20 vite. Komunat që janë në regjion të Prishtinës janë duke e ndryshuar një çmimore, që është mirë me u kordinue me Komunat tjera, që mos me qenë njëfarë ndryshimi në çmim prej Komunës së Obiliqit me Fushë Kosovën, ose me Drenasin që janë regjion i Prishtinës. Pra, kërkoj që kjo pikë të shtyhet për seancën e ardhshme, në mënyrë që me u kordinue edhe me Komunat tjera, dhe me hudhë në votim.

**Sami Ahmeti** – Ne e kemi lexuar këtë Rregullore dhe në shumicën e pikave jemi dakord me të, pikërisht te puna e çmimores unë kam hulumtue shumë Komuna tjera, psh Mitrovica e jugut në muajin e kaluar veç ka miratuar një Rregullore, madje me çmim edhe më të ulët për amvisni, e të mos flasim për bizneset. Unë jam për me bisedue për aspektin e bizneseve dhe tjerave, që kanë të hyra më shumë, por sa i përket amvisnive mendoj se duke pasë parasysh rrethanat është mirë me vazhdue me çmimin e njejtë. Mirëpo, për me i ndihmues kësaj dhe lehtësimit të punës së kompanisë që punon besoj se është shumë më lehtë me i përfshi të gjitha familjet që kanë njehsorë elektrikë, e jo me bë ritjen e çmimeve të mbeturinave. Ne jemi dëshmitarë se në shumë lokalitete, shumë familje nuk kyqen në këtë sistem vetëm përfaktin se ju duhet me pague 4 €, e 65 centë. Mendoj se është një çmim i vogël, por nëse hyjnë të gjitha familjet duke mos i përfshirë ato që janë me social, që edhe ato me social do të hyjnë gjithqysh por duhet të gjendet formë për pagesën e tyre. Mendoj se nuk është arsy që për

çështje të çmimores me shtye këtë Rregullore. Prandaj ne jemi për me vazhdue me këtë Rregullore dhe sidomos që të jetë jemi të gatshëm edhe me dhënë kontribut në shumë pika të kësaj Rregulloreje, me bë më të fortë dhe më të favorshme për qytetarët dhe institucionin tonë.

**Enver Gashi** – Nëse, keni propozim për me shtye, ose mos me shtye këtë Rregullore, e jo me debatue dhe kjo është kompani regionale, e jo komunale prandaj ne me dalë të parët me propozime nuk e shohë të arsyeshme.

**Sami Ahmeti** – Pasi që vendos kompania, atëherë pse është ardhë kjo Rregullore.

**Enver Gashi** – Saron se ne jemi aksionarë dhe jemi një pjesë e aksionit, e jo krejtë.

**Ajet Berisha** – Mendoj se ka nevojë të bëhet njëfarë studimi i fizibilitetit që kompanitë tona dhe Higjienoteknika me u bë vetë funksionale dhe çmimet me qenë reale. Pavarësisht gjendjes së rëndë ekonomike mendoj se çmimet janë të ulëta të shërbimeve që kryhen, gjë që mendoj se edhe e dedikon cilësinë e shërbimit. Çmimi i ulët dhe shërbimi nuk mund të jetë shumë cilësor sepse angazhimi i punëtorëve është shumë më i vogël. Në thelb mendoj se ky çmim pavarësisht gjendjes ekonomike që kemi duhet me qenë real sepse me çmimin real ofrohet edhe shërbimi më i mirë dhe cilësia e shërbimit është më e mirë. Përveç kësaj pjese që kam pasë me ngritë si shqetësim a janë të mjaftueshme dhe a janë reale këto çmime të shërbimit që e bën kjo kompani, me pjesën tjetër plotësisht pajtohem me çdo pikë të kësaj Rregulloreje. Mendoj se edhe me kalue kjo Rregullore sot nuk është ndonjë problem dhe pjesën e çmimores ne në cilindo moment mund ta ngritim, mund ta biejmë si plotësim ndryshim të Rregulloreve. Mirëpo, edhe me shtye në rast se nuk ndikon kurgjë te shërbimet që na ofron kjo kompani, nuk është telashe. Kërkoj falje, por desha të them se shqetësimi im ka qenë kjo edhe te unë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 14 vota për dhe me 5 vota abstenim votuan që të shtyhet pika 3 e rendit të ditës për një mbledhje të ardhshme.

#### Pika 4 e rendit të ditës

**Enver Gashi** - Për një sqarim detal rreth raportit të shpenzimeve për periudhën Janar-Qershori 2022, fjalën ia jepë drejtoreshës së DEFZH-së.

**Zarife Behluli** – Materialin besoj se e keni marrë të gjithë. Paga dhe meditje nga grandi, të hyrat, totali i alokimit është 2,195,248.24, ndërsa shpenzimi është veç pjesa e grandit 2,089,732.67 €, që do të thotë 95.94 %. Mallra dhe shërbime, grand 1,187,050 €, alokimi i të hyrave vetanake 2021, është 20,000 €, dhe bartja e të hyrave vetanake nga viti 2021 në 2022 është 133,541.80 €, totali është 1,340,591.80 €, Shpenzimi është 395,816.68 €, nga grandi, ndërsa nga të hyrat 3,891,61 €, që në total shpenzimi është 399,708.29 €, që do të thotë 29.82 %. Shpenzimet komunale, veç nga grandi 280,675 €, shpenzim 121,345.21, që do të thotë

43.23 %. Subvencione dhe transfere, grand 275,000 €, alokimi i të hyrave vetanake 473,975.92 €, nga bartja e mjeteve 177,394.60 €, që në total 926,370.52. Ndërsa shpenzimi grand është 175,701.65 €, nga fondi 21, 265,934 €, dhe nga të hyrat e bartura janë 86,395 €, total shpenzimi 528,30.65 €, që do të thotë 57 %. Shpenzimet kapitale, grand janë 4,851,714 €, të hyrat vetanake janë 39,087, nga të hyrat e bartura 57,993.85 €, në total janë 4,948,794.85 €. Shpenzimi 270,612.24 €, nga grandi, ndërsa nga të hyrat e bartura është 29,865.19 €, që do të thotë total shpenzimi është 6.07 %.

**Sami Ahmeti** – E thamë edhe në mbledhjen e KPF-së, për hir të aspektit minimal me u shqyrtue një raport financiar, apo i auditorit dhe për seanca të tëra mos me marrë pjesë Kryetari, unë po e shohë si tendencë për injorim, që është një tndencë për injorim të anëtarëve të Kuvendit.

**Enver Gashi** – Ju lutem ti përbaheni rendit të ditës, e përmende auditorin.

**Sami Ahmeti** – Unë e di minotazhën time, e di çka flas, e përmendi edhe auditorin, jam në kuadër të raportit, kështu që të keni kujdes, të keni durim pak se nuk besoj që bëhet e tepërt. Unë fillimisht mendova se na ka ardhë gabim një fletë me 5 rreshta e 9 kolona, që konsiderohet sikurse me u ulë në një zyre dhe me thënë hajt çka po dojmë me kallxue, çka nuk po dojmë me kallxue. Në vija të trasha, një raport që konsideroj se vetëm raport nuk është, nuk është fare profesional, nuk i ka të përfshira asnje fushë në çka janë harxhue ato mjete dhe në çka janë planifikue gjithashtu. Te shpenzimet kapitale, 6.07 %, nuk lë koment do të thotë në kohën më të mirë të funksionimit të mundësisë për me bë investime, ose ndërttime çkado që është paraparë nuk punohet. Në ndërkohë, lehen në muajt e ftosfë, në mënyrë që edhe kualiteti i atyre punëve të jetë ashtu siç po duket shumë herë ende pa përfundue, po duhet edhe me bë renovime. Unë mendova që pikërisht kjo pikë e rendit të ditës, do të kërkohet të shtyhet për seancën e ardhshme në mënyrë që të vjen në Kuvend sepse unë e di se numrat janë megjithatë, Kuvendi është organi më i lartë i kësaj njësie qeverisëse dhe besoj se nuk do të kushtonte shumë, që të bëhet një raport i mirëfilltë me të gjitha fushat. Gjithashtu, po e përsërisë mospjesëmarrja e Kryetarit kur është puna te këto raporte është tendencë për injorimin e anëtarëve të Kuvendit. Nuk është bërë nami pse është dehë e ka bërë skandal në polici, e mos me guxue më me ardhë, gjë s'bëhet le të vjen se të gjithë e njohim personalitetin e tij.

**Ajet Berisha** – Vërtetë, raporti mund të përmban dhe sigurisht që përmban shpenzimin total për secilën linjë në vlerat dhe përqindjet e paraqitura. Mirëpo, është për shqetësim mungesa e transparencës në këtë raport, do të thotë ne si delegatë nuk është dashtë me qenë e nevojshme që bër çdo gjë me bë kërkesa për qasje në dokumente zyrtare. Mirëpo, është dashtë minimalisht që Ekzekutivi me marrë mundin me na e shpjegue secilin shpenzim, llojin e shpenzimit të linjave dhe për çka janë shpenzue. Kjo, kishte me bë këtë qeverisje më transparente, por nuk e keni këtë vullnet e dijmë, që është në rregullë dhe nuk është problem. Për pjesën tjetër, edhe te raportimi ka anakronizma për arsyen e vetme, thotë 95.94 % të pagave dhe meditjeve janë shpenzue. Në rast se në muajin e 6 janë shpenzue 95.94 %, çka bëjmë edhe 6 muaj, vetëm shikojeni tabelën, kur të paraqitet një raport duhet me na shpjegue. Në rast se paraqitet totali i investimeve kapitale, që është 4 milionë e 851 dhe paraqitet përqindja 6.7 %, pse nuk paraqitet totali i pagave për me u paraqitë përqindja, do të thotë ka anakroni në këtë kuptim. Tjetër shifër na e jepin për 6 muaj përqindjen, ndërsa në një vend na e jepin për 12 muaj përqindjen, do të thotë ky është anakronizmi.

**Enver Gashi** – Sqaron se te pagat dhe meditjet mundesh me pa saktë dhe e din se për 6 muaj këto janë të parapara, ndërsa te shpenzimet kapitale është e drejtë e çdo anëtarë të Kuvendit. Te shpenzimet kapitale nuk mundesh me nxjerrë përqindje për 6 muaj, nuk mundesh me nda shumën totale për 6 muaj sepse shpenzimet kapitale merren për një vit, pagat ndahen sepse është numër. Shpenzimet kapitale krejtë janë në proces për atë dhe nuk munden të ndahen.

**Ajet Berisha** – Ju po flisni për mjetet që janë alokue deri më sot dhe kjo është në rregullë. Për investime kapitale janë alokue të gjitha dhe unë po them vetëm se rapporti ka anakronizëm në pasqyrim. Në rast se flasim për alokim deri në muajin e 6, nëpër secilën linjë për paga dhe meditje, për mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe investime kapitale deri në muajin e 6 i paraqesim vlerat vetëm sa janë alokue, e jo sa e kemi buxhetin. Problemi është se në të gjitha tjerat nuk ka ndonjë telashe, por te investimet kapitale për 6 muaj 6.07, është problemi i shpenzimit. Do të thotë se Komuna është duke shkuar

me një ritëm jashtëzakonisht të ngadalshëm dhe detyrohet në 6 mujroin e 2-të, me rritë ritmin, që zakonisht në rritjen e shpejtë të ritmit pastaj, humbë cilësia. Te alokimi nuk është problem sepse drejtoresha po thotë se mjetet janë alokue dhe në rast se janë alokue mjetet, pse nuk kanë fillue punët. Në këtë drejtim është dashur me pasë një arsyetim te paraqitja e raportit se arsyet që shpenzimi është aq i vogël është ky. Në të kundërtën mendoj se ky lloj shpenzimi 6 mujor i bindur jam se nuk do të arrinë sikurse në vitin e kaluar vetëm 82 % i realizimit të investimeve kapitale, që në këtë vit ka me qenë edhe më i ulët.

#### Pika 5 e rendit të ditës

**Enver Gashi** – Hapë debat për Raportin e Auditimit nga ZKA-ja, për vitin 2021 dhe ju lus që kohën ta shfrytëzoni maksimalisht.

**Sami Ahmeti** – Sa i përket kohës, e keni parasysh që për çdo pikë të rendit të ditës shefat e grupeve parlamentare i kanë 10 minuta. Ajo minotazha nuk është e saktë sipas Rregullores, vetëm ta dini se nuk e qojmë aq gjatë vetëm sa me iu tregue se ajo minotazhë nuk është duke shkue në rregullë. Raporti i Auditimit për vitin 2021, ka rezultuar me 12 rekomandime dhe prej tyre 9 janë rekomandime të reja, ndërsa 3 janë të përsëritura. Ajo që është shqetësuese sa janë rekomandime të përsëritura, po aq edhe rritja e tyre nga viti në vit. Në vitin 2020 numri i rekomandimeve ishte 11, ndërsa në vitin 2019, ishin 7. Rritja e rekomandimeve nga viti në vit tregon se niveli i papërgjegjshmërisë në Komunën tonë në vazhdimësi po rritet. Gjatë auditimit për vitin 2021, janë vërejtur parregullësi evidente në fushat e rëndësishme financiare. Disa nga më të rëndësishme janë parregullësitë në zhvillimin e procedurave të Prokurimit, parregullësi në procesin e subvencionimit dhe parregullësi në procedurat e rekrutimit të Personelit. Pastaj, vonesa në pagesat e obligimeve ndaj kontraktuesve, parregullësi për pozicionet e përshkruara në specifikacionin teknik të kontratës, niveli i ulët i realizimit të planit vjetor të auditorit të brendshëm etj. Krejtë këto vërejtje të cekura nga raporti i auditorit janë të mbështetura në fakte, që tregojnë tendencën e keqpërdorimeve. Për shembull te procedurat e Prokurimit caktohet në te kontrata për ndërtimin e bibliotekës së qytetit në paramasa dhe paralogari, pjesa 3, pozicioni 1.1, termo pompa mitsubishi është përcaktuar lloji, apo marka tregtare e pajisjes. Përcaktimi i markës tregtare tregon vetëm një gjë se ai tender është i përgatitur për ofertuesin që ju e konsideroni të duhur. Pastaj, ka edhe shumë vërejtje tjera, për të cilat prapë do të ishte mirë që të ishte Kryetari këtu, mirëpo tendenca është keqpërdorimi i parasë publike dhe i ndikimit të pushtetit. Unë nuk kam diçka me shtue sepse vetë raporti i specifikon çështjet, prandaj shpresoj që viteve të ardhshme, të mos kemi vërejtje të tillë.

**Ajet Berisha** – Pikit tjera, që raporti i auditorit i ngritet dhe që janë me rëndësi është mangësia në menaxhimin e pasurisë kapitale dhe jokapitale dhe raportimi i Komunës, raportimi i gabueshëm, apo gabim qëllimshëm ose paqëllimshëm i pasqyrave financiare vjetore dhe gabimet tjera. Në raportin 1 vjeçar kur është diskutue ne kemi thënë që teprica për këtë vit ka me qenë 2.4 milion, ose është raportue gabimisht, do të thotë e ka konstatuar auditori që pasqyrat vjetore finaniare kanë qenë të raportuara ose qëllimshëm gabim, ose gabime teknike. Prandaj, edhe ato analizat tona në pasqyrimin e pasqyrave vjetore financiare janë të gabueshme, e ka konstatuar edhe auditori sikurse unë si një naiv në ekonomi e kam konstatuar gabim raportimin e këtyre pasqyrave. E rëndësishme është se kjo Komunë nga ky raport i auditorit të jashtëm më intereson një gjë si Ekzekutiv a ka përgatitë, a ka bë lëndë të cilat mund të shëndrohen edhe në padi për sektore të posaçme që tregojnë papërgjegjshmërinë, apo edhe mungesën e mbikqyrjes në veprime në bazë të ligjeve në funksion. E kemi punësimin e njerëzve pa konkurse në Arsim, apo vazhdimi i kontratave edhe kur ata kthehen. Ne kemi kontrata krejtësisht keq të mbikqyrura, siç është kontrata e menaxhimit të parkut, ose mirëmbajtja e parqeve vlera 210 mijë euro, e bazuar në njësi ku ndahet në 5 njësi nga 20 %, që veç njësia e parë paguhet 178,869 euro do të thotë se këto 4 njësítë tjera mbeten pa vlerë, pse është bërë vlerësimi i tillë. Kontrata e sheshit “Adem Prengi” ne e dijmë se sot qe 5,6 punëtorë të Komunës, nuk punojnë për arsyet të një sheshi shumë më të vogël, apo të një parku shumë më të vogël sepse mungon një shportë e mbeturinave, mungon një ulëse. Unë po i përmendi shumë shkurtë vetëm në aspektin e pajisjeve sportive dhe 10,120 euro ka mungesa në sheshin “Adem Prengi”. Nga 390 copë të planifikuara rrethojë e hekurit që auditori këtë e thotë janë realizuar 58 copë dhe për më keq janë paguar 110. Unë nuk e di as çfarë lloj rrethoje është. Kjo

vërtetë është për padi, a ka ngritë diçka Komuna ndaj këtij menaxheri, Kryetari i Komunës e drejtori a kanë marrë masa ndaj këtyre menaxherëve të projekteve. Njësoj u përmendë te biblioteka, që është caktue mbivlerësim dhe për këtë punë kanë shkue 2 punëtorë. Unë te biblioteka nuk po hy që është qështje për padi. Vlerësimin e pasurisë kapitale dhe jokapitale duke mos i regjistruar në sistem që paraqet dëme të jashtëzakonshme, gabimi në raportim nga DEFZH-ja, dhe teprica apo humbja e mjetave 1 milion e 60,000 euro, është shqetësim. Edhe në vitin zgjedhor kur ju përpinqeni me i shpenzue krejtë mjetet 1 milionë e 60,000 euro kësaj Komune, nuk kanë arritë me iu shpenzue edhe janë shumë, kështu thotë auditori. Unë them se po të ishte kjo qeverisje transparente, me rregulla dhe ligj mendoj se 4,5 padi, apo ndërmarrje e masave ndaj menaxherëve të këtyre porjekteve, ishte dashtë me i marrë. Meqë, kjo Komunë nuk ndërmerrë masa ndaj këtyre menaxherëve mendoj se Kryetari i Komunës është i zhytur në këtë shkelje të rënda që ka bërë kjo Komunë.

**Ibush Mjekiqi** – Këtë raport të auditimit e kemi marrë në muajin e kaluar dhe për neve, si qeverisje është shumë e rëndësishme nga se ky raport është i pakualifikuar. Në këtë raport pse janë disa rekomandime, mendoj se këto janë mirë sepse mbi bazën e kësaj veprojmë në planin e veprimit që të eliminohen edhe këto. Shumë shpejtë mbi këtë bazë ne do ti ndërmarrin hapat e mëtutjeshëm të veprimit dhe pa këtë raport ne nuk mund të bëjmë atë që po thotë z.Ajet, apo diçka tjetër. Do të thotë mbi bazën e këtij rapporti bëhet plani i veprimit në qeverisjen komunale dhe do të shikojmë se si do të janë hapat e mëtutjeshëm.

#### Pika 6 e rendit të ditës

**Enver Gashi** – Hap debatin për Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga ZKA-ja.

**Sami Ahmeti** – Kur bëhet një raport normal që bëhen edhe hapat se si duhet të realizohen ato rekomandime, që është normale. Mirëpo, ky lloj planifikimi edhe pse nga Kryetari i Komunës është konsiderue fillimisht në letrën e konfirmimit se të gjitha këto gjetje, të gjitha këto shkelje, të gjitha këto si të duash me ia lënë emrin, me të gjitha këto pajtohet Kryetari i Komunës, se vërtetë kanë ndodhë, qysh e tha parafolësi realisht janë raste për Prokurori, që u cekën shumë. Në ndërkohë në këtë raport janë vetëm disa shenime edhe pse Kryetari në letrën e konfirmimit ka cekë se do të japid datat, do të japid personelin i cili do të caktohet për realizimin e këtyre rekomandimeve. Këtu, më shumë shkruajnë se më nuk do të bëjnë kështu, ose më thjeshtë nuk kemi me vjedhë më, kjo nuk don koment.

**Ajet Berisha** – Unë për me i thënë Nënkyetarit pavarësisht rekomandimeve, ju prapë zotimin e jepni me gojë, por në praktikë nuk realizohen ato po ua japë shembull. Nga planifikimi pika 6, shpenzimet thotë: “klasifikimi i shpenzimeve në kategoritë ekonomike dhe përkatëse Kryetari duhet të siguroj që shpenzimet të klasifikohen dhe paguhën nga buxheti i kategorive përkatëse ekonomike”. Unë vetëm po iu rikujtoj nga mbledhja e kaluar se 300,000 euro, i keni të planifikuara në DSHPE, subvencione. Dikund mbi 100,000 euro, i keni në Drejtorinë e mjedisit dhe planifikimit hapësinor. Nga sot a mund të tregoni se çka ka me u subvencionue me këto mjete në DSHPE dhe në DMM, ose për çka kanë me u shpenzue ato subvencione, të parapara në këto 2 Drejtori. Pavarësisht zotimeve që ju këtu i bëni prapë mjetet të cilat i keqklasifikoni në mallra dhe shërbime, në subvencione ua ndërroni destinimin, ose i bëni paga dhe meditje për çka keni vërejtje në tërë kohën. Sikurse e keni pasë vërejtjen psh që nga 200 punëtorë ju deri në fund të vittit i keni pasë 150 punëtorë, ndërsa pagat i keni shpenzue qind për qind. Kjo, qysh ka mundësi kur 40 punëtorë ju kanë mungue, që nuk ka mundësi me u shpenzue sepse 40 punëtorë kanë qenë më pak në fund të vittit. Pra, janë dikund mbi 30 punëtorë më pak, ndërsa shpenzimin e pagave dhe meditjeve e keni bërë qind për qind, qysh ka mundësi. Në thelb kjo, është matematikë që nuk të lejon me lëvizë. Për këtë është vërejtja e auditorit se ju mallrat e shërbimet i shëndrroni në paga sikurse te DSHPE-ja, i keni vendosë 300,000 euro, që keni me ia dhënë kompanisë komunale për me i shëndrrue në paga, ose edhe te DMM-ja, sepse kompania që e keni ndërtue nuk është e aftë me gjenerue mjete, ose ju nuk jeni të aftë me i dhënë punë asisoji, ose duhet me i dhënë punë asisoji duke shkelë ligje. Pastaj, ju duhet përmes këtyre malverzimeve mallra dhe shërbime, subvencioneve me ua bë pagat atyre punëtorëve, ku keni premtue se keni me i punësue 200 merre me mend 200 i ka krejtë Komuna, edhe 200 keni thënë vetëm në atë kompani, që është jashtëzakonisht e pavërtetë dhe e pamundur. Mirëpo, edhe pagat që ua jepni, ua jepni kundërligjshëm prej mallrave dhe

shërbimeve dhe prej subvencioneve i shëndrroni në paga. Prandaj, ky zotim nr.6, është i parealizueshëm sepse ju prapë keni me vazhdue avazin e vjetër, keni me vazhdue keqklasifikimin sepse ju vyen.

**Valon Svirca** – Unë deshta me pasë si një rikujtim sa auditorë të brendshëm i ka Komuna sepse sa e di unë një organizatë me mbi 5 milionë buxhet duhet me i pasë së paku 3 auditorë të brendshëm.

**Ibush Mjekiqi** – Përgjegjet se vetëm 1 e ka tani dhe e ka Komitetin mbi auditim, ndërsa sa i përket zyres së auditorit është vetëm 1 i caktuar. Ne kemi bë përpjekje për me shtue numrin dhe kemi hapë konkurs, por janë anulue përmes procedurave të rregullta. Ne jemi prapë në përsëritje të këtij konkursi dhe shpresojmë se në një të afërme në të ardhmen ta kompletojmë zyren e auditimit. Sa i përket çështjes së subvencioneve, nuk i ka vetëm 300.000 euro, por ato janë të ndara dhe Komuna jonë i ka mbi 800,000 euro subvencione. Ju e dini mirë se Kuvendi në mandatin e kaluar ka marrë vendim për subvencionimin e rasteve me covid 19, dhe të gjitha pagesat që janë bërë deri më tani kanë shkue në këtë drejtim. Ky subvencion është mendue më heret që të bëhet për një qëllim tjeter, por në mungesë të rregullativës ligjore ka mbetë sepse ka qenë i planifikuar për subvencionimin e rrëmës për banorët e Komunës së Obiliqit. Ndërsa, te fjalori i z.Berisha dhe z.Ahmeti për akuza, ju lus të jeni pak më të kujdeshëm sepse nuk është e nivelit tuaj me u lëshue në këto analiza, jo hajn e gjëra tjera sepse nuk është mirë.

**Ajet Berisha** – Unë nuk cilësova as hajn, që është mirë me i emërue, por unë analizova raportin e auditimit dhe planin për zbatimin e rekomandimeve të auditorit. Fjalën keqpërdorim mund ta përdori sepse mendoj se nga raporti është konstatue se ka keqpërdorime. Me ditë se kush është hajni, unë e bëjë padinë, por edhe për këto si keqpërdorime unë prapë kam me bë padinë tjeter dhe janë organet të cilat e caktojnë se kush është hajni. Unë bëjë padi dhe mendoj se ka keqpërdorim, keqqeverisje, ka korruption dhe në bazë të kësaj duke i mbledhë argumentet e dërgoj te organet gjegjëse. Edhe përkundër që nuk kam ndonjëfarë besimi te organet tona gjyqësore, prapë se prapë unë atyre nuk kam kujt tjeter me iu drejtue, ndërsa juve kam me iu tregue vetëm se çka po thojnë raportet.

**Sami Ahmeti** – Nëse, dikush e ka ndje personale i kërkoj falje. Keqpërdorim është fjala e butë e asaj që e thashë më heret. Keqpërdorim me një fjalë hajni është nuk është diçka tjeter sepse për atë bëhet dhe kjo po e dëshmon sepse ju e dini se në këtë javë 2 persona, u arrestuan për çka është mirë me na tregue, sigurisht jo që kanë shkue në xhami me u falë.

**Enver Gashi** – Nganjëherë demokracia nuk është me folë çfarë të duash dhe unë nëse, i them dikujt ke keqpërdorë diçka kam me i thënë e ke marrë këtë laps, e kam parë se në shtëpi e ke dërgue. Ju, mund të dyshoni dhe janë organet që merren me këtë çështje, që janë staf i madh i hetuesisë, policisë e prokurorë dhe të gjithë këta veprojnë. Askush askujt sot nuk mundet me ia ndalë për me paditë diçka, por psh me më paditë mua që nuk e kam marrë lapsin, pastaj ka edhe sanksione ligjore.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 11 vota për, 5 vota kundër dhe 1 votë abstenim e aprovuan Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga ZKA.

#### **Pika 7 e rendit të ditës**

**Enver Gashi** – Paraqet kërkësen e DPUKP-së, për ndryshimin e vendimit nr.-I-69, të dt.30.04.2021, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personit fizik Hashim (Rifat) Berisha.

**Arben Berisha** – Në bazë të zyres së vlerësimit prej Ministrisë së financave dhe në bashkëpunim me palën që kemi me i këmbye pronat z.Hashim (Rifat) Berisha, i cili e ka dhënë pëlqimin se pranon dhe krejtë janë 15 ari, do të thotë 1,507 metra, parcela e cila hiqet. Vlerësimi është bërë për 2 pronat, do të thotë edhe për pronën tonë dhe zotëriut në fjalë. Ne vlerësimin nuk mundemi me dhënë deri në përfundim të procesit. Është një pronë që prekë edhe në ujërat e Kosovës, që është aty në rrjedhojë dhe prekë në rrethojën e RTK-së, së atëhershme, kështu që si kërkëse e jona është pëlqimi i palës, që me u tërheqë kjo parcelë. Pala pajton me ato parcelat tona dhe me parcelat e veta me i këmbye.

**Ajet Berisha** – Duke mos e ditë vlerësimin përfundimtar të Ministrisë, apo të Komisionit të Ministrisë së financave, mendoj se është interes me u heqë ajo edhe pse ajo pjesë e RTK-së, tash e RTP-së së mëhershme, ai vendim me marrë atë pjesë RTK-ja, nuk jam shumë i sigurtë, nuk e di a ka pasqyrim në kadastër.

Është marrë në vitin 98, 99 dhe ata e kanë zgjerue rrrethojën për shkaqe të sigurisë së tyre, që e kanë marrë edhe një pjesë që mendoj se ka qenë pjesë komunale. Mund të jem në gabim, por sido që të jetë në këtë raport mendoj se është në interesin e Komunës, që sa më pak me i dhënë atij, por nuk është qëllimi ynë. Mirëpo varet se qysh bëhet vlerësimi dhe a ka me pague ai ose atë pjesë shtesë dhe këto i din drejtori. Interesi i Komunës dhe interesi i qytetarëve të Bakshisë është i jashtëzakonshëm, që me u bë ky këmbim sepse ky fshat ka mungesë të hapësirave komunale publike për me bë aktivitete. Ata banorë sa janë aty 500-700 banorë, nuk kanë as fushë sportive, as asnjë hapësirë të lirë ku mund ta bëjnë ndonjë aktivitet. Kjo çështje është nisë mjaft heret dhe është vonue mjaft shumë, por shpresoj se Drejtoria dhe Ekzekutivi i tanishëm më në fund kanë me ardhë në atë pikën ku do të bëhet ky këmbim dhe ka me fillue investimi për ata qytetarë.

**Sami Ahmeti** – Duke pasë parasysh rëndësinë e asaj çka planifikohet të bëhet në atë parcelë, ne gjithmonë jemi për çfarëdo ndryshimi që parashihet të bëhet.

Është pak e çuditshme qysh iu ka dhënë prona e huaj dikujt tjetër sepse kjo qysh e tha parafolësi prej viteve të 90-ta, ka qenë pronë e RTK-së. Duke pasë parasysh se krejtë dokumentet i keni në pronësi dhe iu keni dhënë pronë të huaj, keni bërë këmbimin e pronës së huaj me dikend, nuk don koment. Megjithatë, ne do të votojmë për nëse ka nevojë këtë ndryshim plotësim të këtij akti për faktin se atëherë, nuk e keni bërë vlerësimin e ligjshmërisë së saj. Ju lutemi, gjithashtu që të shikoni, që të mos ketë konsekuenca ligjore sepse pastaj Komuna po paguan para të majme për çështje të gabimeve tona, apo të punës tonë që nuk po e bëjmë qysh duhet.

**Arben Berisha** – Ne pa vlerësim të ligjshmërisë së Ministrisë që ka ndodhë më heret në mandatin e kaluar nuk kishim guxue as në Ministri me dërgue për me bë vlerësimin e pronave. Ligji e thotë në momentin kur shpallen zgjedhjet gjithçka aty për aty ndalet procesi dhe kthehet në pikën 0. Ne kemi marrë një konfirmim nga Ministria, se kemi të drejtë me vazhdue për arsy se është bërë vlerësimi. Të gjitha proceset janë të rregullta përvèç se edhe kjo pronë në aparatin kadastral është pronë e Komunës. Nëse, ne marrim prapë një vendim që nuk po e térheqim dhe ne mundemi me ua shtye rrrethojën, asnjë telashe nuk e kemi. Mirëpo, kjo pronë palës prapë në shfrytëzim nuk mund ti hyjë, për arsy se prekë edhe në ujëra. Kjo, pse ka ndodhë nuk është bërë nami i madh dhe ne po i térheqim të gjitha parcelat që prekun për këmbim është fjala, pronat tona dhe pronat e zotëriut 530 m<sup>2</sup> i ka ai më tepër që ne ia marrim atij. Mirëpo, pastaj vlerësimi i pronave bëhet prej Ministrisë dhe përcaktohet shuma e mjeteve, kush kujt i ka borxh. Unë edhe një herë po ju them se ligjshmërinë e kemi dhe komplet lënda është e pastër.

**Ibush Mjekiqi** – Qëllimi i të gjitha këtyre veprimeve është krijimi i hapësirave qysh e tha z.Berisha, dhe mbi bazën e kësaj ne nuk kemi mund pa e krye këtë veprim me zhvillue një fushë sportive aty, për rekreacion për ata banorë. Po ashtu, drejtori dhe tjerët thanë se sot është me rëndësi të merret vendimi sepse po qe se ata 15 ari votohen ndryshe, nuk mund ti kalojnë palës në veprim. Mendoj se duhet të merret vendim për këmbimin e pronave komunale me banorin që ka interes edhe ai edhe ne, ndërsa pjesa tjetër me RTK-në, mabetë të shqyrtohet.

**Ajet Berisha** – Mendoj se edhe Nënkyetari dhe drejtori e sqaruan mjaftueshëm dhe nga terreni atje, e di se janë vitet 97,98 që RTK-ja e atëhershme e pati zgjerue rrrethojën për arsyet e sigurisë së vet. Unë pajtohem që me RTK-në e tashme ata 15 ari, me i shqyrtue Komuna se kujt i takojnë sepse ata me vendim e patën zgjerue. Mendoj se është interes i joni, që më vjen keq me thënë, por këta 15 ari, me i mbetë Komunës dhe mos me ia dhënë atij, është interes. Tash sa do të bëhet vlerësimi dhe a kemi me i pague ne atij, është çështje e Komisionit. Mendoj se ne nuk duhet me hezitue edhe nësa na bjen me pague diçka, që shpresoj se nuk na bjen.

**Enver Gashi** – Atëherë, në atë vendimin që e kemi marrë ne e kemi përfshi këtë 15 ari e 7 metra, dhe kjo është krejtë esenca. Është në dobi të qytetarëve dhe një rast shumë i mirë që ne me iu bë një infrastrukturë të cilën do ta shfrytëzojnë të gjithë qytetarët.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 16 vota për e aprovuan Vendimin për ndryshimin e vendimit nr.-I-69, i dt.30.04.2021, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personit fizik Hashim (Rifat) Berisha.

#### **Pika 8 e rendit të ditës**

**Enver Gashi** – Hap debat për raportin e Komisionit mbi pronat komunale që janë dhënë në shfrytëzim për 99 vite.

**Sami Ahmeti** – Ne vazhdojmë të besojmë se shumica e këtyre pronave janë dhënë pa kritere, me lidhje dhe disa edhe me ryshfet. Faktin që shumë prej tyre vazhdojnë të mos plotësojnë kushtin e kontratave, e bënë këtë punë edhe më skandaloze. Edhe një raport të vitit të kaluar e kam parë në vlerësimë përafërsisht të përafërt, por nuk besoj se as pandemia, as lufta e Ukrainës, ku shumica e arsyeve fokusohen aty, të kenë qenë shkaqet për këto prolongime. Sido që të jetë si LVV, ne kemi zyren tonë ligjore dhe ata kanë filluar të punojnë, një kallëzim penal mbi bazën e këtij rapporti për disa subjekte afariste, që nuk i kanë plotësuar kushtet e kontratës. Ne vazhdojmë të besojmë se pas këtyre pronave qëndrojnë aferat e shumta korruptive.

**Ajet Berisha** – Nga analiza e këtij rapporti, pavarësisht që në shumicën e pjesëve të saj është i mangët nuk na njofton brumë të mjaftueshëm për me bë vlerësimin. Mendoj se nga datat e kontratave dhe nga viti zgjedhor që ka qenë viti i kaluar 2021, titor dhe në bazë të ligjit 6 muaj, më heret pushojnë të gjitha aktivitetet nga 25 prona, 8 prona në bazë të datës së kontratës janë dhënë në mënyrë të paligjshme. Pastaj, kemi një numër të madh të këtyre pronarëve, që i kanë marrë këto prona edhe përkundër që ka kaluar afati për planin dinamik, që ata kanë planifikue me realizue investimin, ata ende nuk kanë fillue, ose janë në fazën e rregullimit të dokumentacionit, gjë që është pyetje për secilin prej tyre. Dikush e ka kalue një vit, dikush 6 muaj e dikush është në fazën përfundimtare të investimit dhe arsyetohen gjëja për covid, ose lufta në Ukrainë, që këto probleme në botë s'kanë me u ndalë kurrë. Do të thotë këto, është dashtë me i pasë parasysh ata. E rëndësishme është pyetja çka ka ndërmarrë Komuna për këto subjekte, që iu kemi dhënë pronë në emër të rritjes së vlerës së asaj prone dhe punësimit të qytetarëve tonë, a ka marrë ndonjë hap që nuk e ka realizue planin dinamik, apo e ka ndërmend me nxjerrë ndonjë vendim me ia sjellë prapë Kuvendit, me thënë zgjatja këtë afat, ose ndërpresa kontratat. Mendoj se disa prej këtyre subjekteve duhet me ua ndërpresa kontratat sepse ende nuk kanë fillue, ndërsa iu ka kalue afati i planit dinamik të tyre. Kjo, jo që nuk e ka rritë vlerën e pronës, por ka ndikue negativisht edhe në punësim. Tani, ka edhe kompani tjera, që thotë se i kam 40 punëtorë, 4 të Komunës së Obiliqit, ndërsa ne e japim për qëllimin e punësimit të të rinjëve tonë. Do të thotë cili është qëllimi me ia dhënë dikujt pronën që nuk është hiç i kësaj Komune, që ai ka aplikue dhe ka fitue në bazë të kritereve, por ka pasë një kriter punësimin e qytetarëve tonë dhe nuk e ka bërë. Unë e di se Apollonia i ka kërkue 5 punëtorë kur isha Nënkyetar, prej tyre unë 10 i kam dërguar të kualifikuar dhe ka thënë jo nuk më pëlqen. Ai vetëm formalisht e bënë kërkësën në Komunë dhe në fund jo i gjeta ata të Podujevës sepse është nga ai vend. Edhe këtu duhet me vendosë njëfarë kriteri se ai ka me i punësue këta punëtorë. Në thelb mendoj se Ekzekutivi aktual e ka për obligim me u marrë në mënyrë shumë serioze me kërkësat e tyre, kur thojnë na mungon infrastruktura, rrryma, rruga, uji e tjera, që ne e kemi obligim me i krijuar ato kushte. Interesi ynë është me u dhënë këto prona, interes i ynë është me u rritë vlera në bazë të ligjit dhe interes i ynë është me u punësue qytetarët tonë. Një prej bizneseve tona në planin dinamik i ka kërkue 8 vetë, ndërsa në vitin e parë ai i ka punësue, do të thotë ka edhe biznese të tilla, që janë duke e kryer veprimtarinë e vetë mrekullueshëm. Mirëpo, ka të tilla që ju duhet me bë vlerësimin dhe me na e sjellë neve, që ndaj tyre me u marrë një vendim tjetër, ose me tërheqë atë vendim për dhënien e pronës për 99 vjet. Ndërsa ai s'ka arritë me realizue në planin dinamik tash dhe ka kalue një vit, bille me ia ulë 10 vite nëse bën diçka mirë, e nëse nuk bën me kthye pronën sepse ne po humbim. Këto prona janë dhënë për interes të Komunës, e jo për interes të tyre dhe ne i japim për shkak se kemi interes ndërsa, ata interesin e Komunës nuk po e realizojnë.

**Shaip Paloja** – Mendoj se me vetë faktin se është formuar një Komision për shqyrtimin e atyre pronave është pozitive dhe duhet me vlerësue. Sido që të jetë ai Komision, na ka ofruë një raport dhe në atë raport pjesa më e madhe e tyre, nuk e ka zbatue kontratën që ka qenë e obligueshme. Unë kam qenë në mandatin e

kaluar dhe gjatë prezantimit të tyre kryesisht kanë prezentue se do të ketë zhvillim ekonomik brenda Komunës së Obiliqit, do të ketë punësim dhe punësimi do të jetë shumë më i madh. Siç po shihet, ata jo që nuk kanë punësue, por as që kanë fillue me implementim të kontratave. Prandaj në të ardhmen unë kisha propozue që me qenë një Komision miks Kuvendi komunal dhe Ekzekutivi dhe seriozisht të merremi me këtë çështje.

**Arben Berisha** – Unë po detyrohem me marrë fjalën për arsyen e po e shohë se po devijon informata e saktë, e cila është dhe nuk lexohet raporti, por i jepni konotacion krejtë ndryshe. Së pari po i referohem parafolësve që thojnë se ka ryshfet, nuk është plani dinamik dhe janë dhënë pronat në formën e paligjshmne. Për çdo pronë të dhënë e kemi ligjshmérinë prej MPL-së dhe nëse dikush thotë se janë dhënë në formë të paligjshme, kjo është turp dhe nuk është në rregullë sepse dikush neve, na shikon dhe tani jemi edhe në formën drejtëpersëdrejti. Duhet të keni kujdes përfjalën kur anëtari i Kuvendit flet, kështu që përfshijen e ligjshmërisë nuk kam të flas më tepër sepse e kemi ligjshmérinë nga të gjitha Ministritë përkatëse. Të gjithë ata që i kanë marrë pronat kanë në planin dinamik se sa kanë me ndodhë investime. Unë ia them këtu Kryetarit, se jemi me lëvdatë në nivelin e Kosovës, që e kemi bërë një zonë industriale, një zonë zhvillimore që ka ndodhë atje, jashtëzakonisht e mirë. Tash, dikush prej juve thotë tash shumica dhe ju së pari a e dini sa prona i kemi dhënë në shfrytëzim, sa janë ndërtue, sa nuk janë ndërtue dhe si e nxjerrni ju atë shumicën. Ne i kemi dikund veç 7 fabrika që janë ndërtue, i kemi 3 leje ndërtimore që i kemi dhënë në javën e kaluar, që 70 % kanë rezultuar pozitivisht dhe janë ndërtue e, janë duke u zhvillue fabrikat. Megjithatë, qe një vit ua kemi dhënë. Planin dinamik e kanë mbi 3 vite, ka që e kanë edhe 5 vjet dhe ka që e kanë edhe 8 vjet. Mirëpo, ka që e kanë ndërtue edhe brenda 6 muajve. Të gjitha këto rezultojnë një pozitivitet që duhet me thënë se për nivel të Kosovës jemi shembull, edhe nga Ministritë dhe nga Komunat e kolegjumet që i kemi. Unë e them edhe njëherë se ajo që ka ndodhë atje, është një mrekulli dhe ju duhet me ndje veten mirë që atje ka ndodhë një mrekulli.

**Valon Svirca** – Unë nuk e di pse sa herë e merrni fjalën gjithë thoni jo mos thuaj kështu, jo po thua kështu, jo pse kështu dhe ne nuk mundemi me ju pyet asnjërin prej drejtoreve, as juve se çka me folë. Nëse mendoni se po e taprojmë diçka mund të drejtoheni dikund tjetër, e jo cili drejtor që e merrë fjalën thotë kujdes fjalorin, mos thuaj kështu, mos thuaj ashtu, që më duket se nuk është në rregullë. Sa i përket punësimit që nuk i marrin punëtorët problemi është se këta, kanë dëshirë kështu, pastaj në vitin zgjedhor me ndonjë subvencion, kështu që është normale përfshirë Komunën.

#### Pika 9 e rendit të ditës

**Enver Gashi** – Paraqet kërkesën nga Kryetari i Komunës, për plotësim ndryshimin e vendimit të Komisionit përfshirë Këshillave lokale atë: në vend të Naim Miftarit, do të jetë Lendita Bekteshi Memishi, në vend të Zelushe Kelmendit, do të jetë Debora Peci dhe në vend të Albana Shillova Shalakut, do të jetë Valon Svirca

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 17 vota përfshirë Vendimin përfshirë ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.-I-69, të dt.29.06.2022 të Komisionit përfshirë Këshillave lokale me këta anëtarë: 1. Lendita Bekteshi Memishi, drejtoreshë e DAP-së, në vend të Naim Miftarit, 2. Debora Peci, nga Demokracia plus në vend të Zelushe Kelmendit nga shoqëria civile, Valon Svirca, anëtar i Kuvendit komunal (LVV) në vend të Albana Shillova Shalakut, anëtarë e Kuvendit komunal (LVV).

**Enver Gashi** – Paraqet kërkesën nga MAPL-ja, përfshirë vendimit nr.-I-64, të dt.28.04.2022, për aprovimin e Rregullores përfshirë subvencionimin e energjisë elektrike dhe caktimin e kuotës më të ulët përfshirë çmimin e energjisë elektrike në zonën e rrezikuar mjedisore në Komunën e Obiliqit.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota përfshirë 5 vota abstenim e aprovuan Vendimin përfshirë Shfuqizimin e vendimit nr.-I-64, të dt.28.04.2022, përfshirë aprovimin e Rregullores përfshirë subvencionimin e energjisë elektrike dhe caktimin e kuotës më të ulët përfshirë çmimin e energjisë elektrike në zonën e rrezikuar mjedisore në Komunën e Obiliqit.

#### Pika 10 e rendit të ditës

**Enver Gashi** – Paraqet reagimin e znj. Zelushe Kelmendi, ndaj asambleistik të LB-së, z.Ajet Berisha, i cili me dt.29.06.2022, në seancën e Kuvendit komunal e ka përmendë zonjën në fjalë gjatë përgjedhjes së saj në Komisionin për përgjedhjen e Këshillave lokale.

**Valon Svirca** – Paraqet një kërkesë për rr.“Hasan Hasani” përballë te Migena, e cila ka nevojë për asfaltim, që nuk e di mund të jetë 200, apo 300 metra dhe nëse mundet Nënkyretari, me ma dhënë një përgjegje.

**Ibush Mjekiqi** – E di saktë për cilën rrugë po thua, që është një problem përafërsisht sikurse në Bakshi. Është çështje prone, e jo e investimit dhe ne jemi duke u marrë me këtë çështje, që besoj se do ta zgjidhim.

**Sami Ahmeti** – Në seancën e kaluar e biseduam çështjen e betonjerës te lagija “Aliu” dhe nga qytetarët kam informata se personi i cili e ka vendosë atë betonjerë këtë javë, që jemi ka fillue me i montue disa pjesë plus. Dua të di deri ku ka shkue gjendja, a është dhënë ndonjë leje, nëse po mbi çfarë baze.

**Ibush Mjekiqi** – Përgjegjet se leja nuk është dhënë dhe Drejtoria e inspeksionit është në vazhdimësi duke e monitoruar dhe nëse, ai vepron vendimi është për ndalim të punimeve. Edhe qytetarët e kanë të drejtën me informue për diçka që nuk është në rregullë.

**Sami Ahmeti** – Realisht këtë nuk e bëra si kritikë, të mos keqkuptohemi se bash këtu, nuk dua të bëjë politikë. Na e ka bë ferr jetën një tjeter afër shtëpisive tona, e di sa i keq është. Mirëpo, ai dje dhe pardje ka montuar pjesë në të njejtin objekt, ta keni parasysh dhe deshta me ditë vetëm nëse, është dhënë ndonjë pëlqim për këtë çështje.

**Ajet Berisha** – E para, znj.Zelushe nuk e kam përmendë, unë por e ka përmendë raporti, keni thënë me hy në atë Komision pa asnjë procesverbal, kaq e thjeshtë është. Unë them se a ka ndonjë procesverbal që është zgjedhë prej OJQ-ve, znj.Zelushe sepse gjithmonë vetëm znj.Zelushe po qëllon e po zgjedhet dhe prapë e them dhe sa të don le të më përmendë znj.Zelushe. Po ashtu, edhe kjo tjetra, që është zgjedhë sot edhe për këtë nuk ka procesverbal, prandaj çfarë mund të them unë tjeter përveç që rregullat nuk po respektohen. E dyta, në mbledhjen e kaluar e kam bërë një pyetje dhe drejtori i DPUPK-së, nuk është përgjegjë. Komuna ka paguar një pronë që iu ka dhënë stacionit të policisë, cila është forma. Ne e kemi blerë prej privatit dhe iu ka dhënë stacionit të policisë me i lënë veturat e tyre private, çka ka fitue Komuna prej dhënieve së kësaj pronë sepse kur e kemi ble ua kemi dhënë atyre, pse. Kërkoj të di se a ka ndonjë dokumentacion, me na sjellë sqarimin se qysh ka shkue kjo pronë. Institucionet janë të ndara, pavarësisht që jemi një shtet, asnjë Ministri nuk të jepë gjëra pa këmbim, pa një marrëveshje që fiton diçka, nuk të jepë. Prandaj, në rast se atyre është dasht ë me ua dhënë pronën, çka kemi fitue ne prej kësaj. Unë nuk e di procedurën se qysh ka shkue, por e di se prej një fqinjë tim është blerë, e di që policia e ka vendosë njëfarë rrithje dhe i futin veturat e veta private. Unë për këtë çështje kam kërkuar sqarim, por nuk kam marrë.

**Arben Berisha** – Po përmendet institucioni, institucioni dhe unë nuk mund të japë përgjegje dhe nuk kam mund asnjëherë me i dhënë përgjegje anëtarit të Kuvendit, nën Metin, mbi Metin, te policia. Ai duhet me cekë numrin e parcelës, ose le të vjen te unë dhe merrë informatë të saktë. Mirëpo kërkesa në mënyrë institucionale duhet të bëhet me numër parcele sepse unë nuk di se ku është nën Metin e mbi Metin.

**Mbledhja përfundoi në ora 11:33’**

Bashk.prof.për punë të KK

Azize Zeneli

Udhëheqësi i mbledhje së KK  
Enver Gashi

